Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 740/13
Datë: 23.10.2013

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 22.10.2013 nxjerr këtë:

VENDIM

Instituti për Banka dhe Financa- IBF, në Prishtinë, duhet plotësuar kushtet deri në afatin e caktuar (01.04.2014), për të marr akreditim dhe aprovim për këtë/o kualifikime:

1. **Nëpunës/Nëpunëse e bankës, me kodin e klasifikimit 4122.03 (niveli III i KKK-së).**

Kushtet:

- Kualifikimi duhet të jetë i unifikuar me module (edhe të gjitha specifikat e moduleve, si kreditë dhe vlera e tyre, rezultate e matshme, kritere e vlerësimit) dhe i bazuar në Standarde profesionale për Nëpunës/Nëpunëse e bankës dhe shfaqja e tij (reklamimi edhe ofrimi) të bëhet si i tillë e jo i ndarë.
- Përpilimi i testeve të jetë sipas kritereve dhe të kenë përqindje të caktuar të kalimit;
- Rishikimi I numrit të kredive për module duke përfshirë anën teorike dhe praktike, vlerësimin, etj. Bazuar në marrëveshjen për kreditë, ku një kredi është barabartë me 10 ore nominale.
- Pjesa praktike (e cila realizohet në klasë) duhet që kandidatët përveç trajnimit në banka të ndryshme, duhet që edhe gjatë vijimit në klasë të kenë një PC para tyre dhe të kenë mundësi dhe qasje në programet e ndryshme bankare.

- Gjatë trajnimit në bankë duhet krijuar mekanizma vlerësues për performancën e kandidatit.

- Duhet të bëhet harmonizimi i kredive dhe njëkohësisht edhe shtrirja e orëve të kredive për orët profesionale teorike dhe lendet e përgjithshme njëkohësisht edhe praktika profesionale që rezlizohet në dy banka komerciale vendore.

- Të posedojë pajisjet e vlerësimit për kandidatë.

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë: 22.10.2013, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;

- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit;

- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe

- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK deri më 01.04.2014.

3.1. Për verifikimin e kushteve dhe rekomandimeve të caktuara , AKK mbledh panelin vlerësues të përbërë nga tre ekspert të fushave përkatëse.

3.2. Në bazë të rezultateve dhe rekomandimeve të dala nga vizita e eksperteve, KD i AKK-së do të marr vendimin për aprovim/akreditim ose mos aprovim/akreditim.

3.3. Institucioni "Instituti për Banka dhe Financa- IBF" obligohet që të marr mbi vete shpenzimet për ekspert (një ditë pune sipas UA nr.1/2011), institucioni është i liruar nga pagesat tjera administrative.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet:

   - Instituti për Banka dhe Financa- IBF;
   - AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi